E martë, 14 dhjetor 2021

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëdita. Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Së pari të prezantohen të pranishmit.

Zonja Prokurore e keni fjalën.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës. Mirëdita të gjithëve. Prokuroria sot përfaqësohet nga Prokurori Cezary Michalczuk; Menaxherja e lëndës Julie Mann; dhe stazhierja Ari Billota; dhe unë Silvia D'Ascoli, Ndihmësprokurore.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit zonja Prokurore.

Mbrojtësja e Viktimave, keni fjalën.

ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës, mirëdita të gjithëve. Viktimat sot përfaqësohen nga Marie-Pier Barbeau, Ndihmësjuriste e lartë dhe unë Liesbeth Zegveld, Bashkëmbrojtëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit.

Avokati i Mbrojtjes keni fjalën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Mirdita të nderuar Gjykatës. Mbrojtja sot përfaqësohet nga Bashkëmbrojtësi, zoti Betim Shala, përkthyesi dhe hetuesi zoti Fatmir Pelaj dhe unë Kryembrojtësi Julius Von Bone. Me videolidhje nga bashkohet dhe zoti Mustafa.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit zoti avokat.

Zoti Mustafa, më dëgjoni në rregull?

I AKUZUARI: Po zonja Kryetare.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Për procesverbalin ky proces zhvillohet përpara Trupit Gjykues I.

Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse do t'ju jepja dy referenca.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do e kërkoja. Po faleminderit.

Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Ajo tek e cila u mbështetëm dje ishte së pari, çështja e fjalës "arrestuar" që është në faqen 16, rreshti 19 dhe 20 i transkriptit të ditës së djeshme.

Dhe çështja tjetër kishte të bënte me moshën mesatare, faqja 37, rreshti 20 dhe 21 i transkriptit.

Këto janë dy referencat.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Në përgjithësi, mirë do të ishte që këto referenca të jepeshin gjatë seancës kur bëjmë pyetjet ose maksimumi deri në fund të së njëjtës seancë. Megjithatë, faleminderit.

Mund të vazhdojmë tani me dëshminë e dëshmitarit. Sot e ka rendin Trupi Gjykues për të bërë pyetjet.

Zonja asistente e sallës ju lutem shoqërojeni dëshmitarin të hyjë në sallë.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes.

Zoti dëshmitar. Mirëmëngjes. Mirë se jeni rikthyer në Dhomat e Specializuara. Më dëgjoni në rregull?

DËSHMITARI: Po, shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja asistente e sallës, a është i ndezur mikrofoni tani se nuk e shikoj dot prej këtu?

Më dëgjoni zoti dëshmitar?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. A patët kohë me pushu ndopak?

DËSHMITARI: [E padëgjueshme].

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ndiheni mirë sot?

DËSHMITARI: Shumë pak kam pushuar. Po mirë, mirë,

faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. Sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Tani rendin e kanë anëtarët e Trupit Gjykues, ne Gjykatësit që t'ju bëjmë disa pyetje. Kemi nevojë që të sqarohemi më shumë. Të marrim më shumë hollësi për disa prej gjërave për të cilat keni dhënë dëshmi këtu.

Ju rikujton se jeni ende nën betim.

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe se duhet të vazhdoni të na tregoni të vërtetën.

Për shkak të natyrës së pyetjeve që do të bëj, unë mendoj se është më mirë të kalojmë në seancë private. Parashikoj se të gjitha pyetjet do të bëhen në seancë private.

Zonja Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit zonja Sekretare.

DËSHMITARI: W04674 [Vijon]

Pyetje nga Trupi Gjykues:

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti dëshmitar, dje në transkript bëhet fjalë për faqen 24, rreshti 18 dhe 19 -- dje na thatë se disa prej të burgosurve kur

erdhën në *[REDAKTUAR]*, i treguan fshehurazi *[REDAKTUAR]* se ishin maltrajtu.

Py. Kjo është.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund t'i shpjegoni Gjykatësve, përse duhej t'ia thoshte fshehurazi ai?

Py. Pse mos e -- *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] *[REDAKTUAR]*

Py. I ka ardh keq me na tregu që *[REDAKTUAR]* e kanë maltrajtu edhe ma shumë se ne. Tani, ka thënë "na kanë maltrajtu të tanëve".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por ata *[REDAKTUAR]* i treguan që edhe ata vetë ishin maltrajtu.

Py. Po. Por veç *[REDAKTUAR]* ma shumë. *[REDAKTUAR]* dhe një tjetër - kanë thënë ata, janë maltrajtu ma shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit që na e sqaruat këtë. Tani e kuptojmë më mirë.

Mos kishte të bënte edhe me faktin se mos kishte frikë, mos po kishte frikë me tregu?

Py. Nuk besoj për frikë. Veç që i ka ardhur keq për të na tregu që *[REDAKTUAR]* është shumë i maltrajtum dhe s'ka dashtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Po dje gjatë dëshmisë tuaj, bëhet fjalë për

faqen 28, rreshtat 5 dhe 6, na thatë se dy muaj pas ofensivës serbe, u kthyet prej Prishtine.

Py. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe thatë se me të filluar ofensiva, ditën kur erdhën të burgosurit në *[REDAKTUAR]*, ju shkuat në Prishtinë.

Py. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pyetja që kam është kjo: Kush u nis për Prishtinë atë mbrëmje apo atë ditë? Ishe *[REDAKTUAR]* apo ishte edhe *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Py. Po ne *[REDAKTUAR]* na bashkë me një traktor kemi shku.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pas dy muajsh jeni kthyer...

Py. Po, jemi kthyer.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] ...prej Prishtine. U kthyet të gjithë bashkë, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Py. Po. *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pak a shumë kur ka ndodhur kjo?

Py. Ah datat i harroj dhe s'i kanë hyrë ushtarët e NATO-s, menjëherë. Kam harruar datat vallahi, nuk i di.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit që na e sqaruat. Në rregull.

Dje - është në transkript faqja 82, rreshtat 8 dhe 9, ju na konfirmuat se *[REDAKTUAR]* ju tregoi se *[REDAKTUAR]* ishte çuar në zonën e *[REDAKTUAR]* Po kështu na thatë, është në faqen 673, se *[REDAKTUAR]* nuk deshi që t'ju tregonte se *[REDAKTUAR]* ndodhej në Zllash.

Tani, pyetja ime është kjo: A i the ti këtij *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* pra se çfarë dije që më përpara. Çfarë kishte mësuar nga njerëzit, nga këta të burgosurit që kishin ardhur *[REDAKTUAR]*. A e konfrontove. A i the "*[REDAKTUAR]* shiko se janë edhe këto fjalë?

Py. Jo. Nuk e kam pyetur kurrgjë tjetër, vetëm "*[REDAKTUAR]* ku gjendet". Më ka thënë "*[REDAKTUAR]* e kanë çuar në zonën e *[REDAKTUAR]*". "A është e vërtetë *[REDAKTUAR]*". Tha "E vërtetë është". Ajo s'kishte qenë e vërtetë hiç.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po a e besove ti këtë përgjigje?

Py. E besova.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ta mbaroj pyetjen se për ndryshe pastaj nuk e përkthen dot as përkthyesi. Nuk e bëjnë dot siç duhet. Ta mbaroj pyetjen. E besove ti *[REDAKTUAR]* në atë moment?

Py. Po e besova se kisha qejf me ditë që është diku.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe

kur i the këtë informacion ti nuk e dije a ishte e vërtetë, se të burgosurit nuk është se të thanë ty, po i thanë *[REDAKTUAR]* se ai i burgosur diku. Pra, ti kishte informacion prej të cilit ti mund të besoje se ajo që të tregonte *[REDAKTUAR]* nuk ishte e vërtetë.

Py. *[REDAKTUAR]* unë e kam takuar mbas ofensivës. Mbasi kanë shkuar ata në Prishtinë, mbas një kohe, unë kam qenë në katund, jam takuar me *[REDAKTUAR]*, kemi ikur bashkë në Prishtinë. Q'aty e kam pyetur *[REDAKTUAR]*.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] po, por mund t'i kishe thënë *[REDAKTUAR]* "këqyre, dikush mua më ka thënë se edhe *[REDAKTUAR]* ka qenë i burgosur aty".

Py. Ai më ka thënë që ka qenë i burgosur po e kanë çuar në zonë *[REDAKTUAR]*.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

Në deklaratën që i keni dhënë Prokurorisë, u diskutua edhe dje pak dhe po citoj, po lexoj për procesverbalin 076509-TR-ET, Pjesa 1, faqja 15 rreshtat 9 dhe 10 - aty keni thënë:

"*[REDAKTUAR]* ishte rrugës për *[REDAKTUAR]*. *[REDAKTUAR]* e ndaloi dhe i tha: "kam urdhër të të marr".

Unë e di që ju vetë nuk keni qenë aty, *[REDAKTUAR]* ishte aty...

Py. Neziri.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A di

gjë mos vallë *[REDAKTUAR]* i tregoi *[REDAKTUAR]* ndonjë urdhër me shkrim, në letër, të shkruajtur?

Py. Jo, nuk, nuk s'më kujtohet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. More vesh ndonjë gjë tjetër për këtë urdhrin. Për shembull kush e kishte dhënë urdhrin?

Py. Nuk di unë, kurrgjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Në deklaratën që i ke dhënë ZPS edhe njëherë me numër ERN 076509-TR-ET, Pjesa 2, faqja 4, rreshtat 4-6; do të përmend rreshtat 21 dhe 22 pastaj - ke thënë kur po flisje për atë që mendoj se kishte qenë burgu ku ishte mbajtur *[REDAKTUAR]* kishte pas qenë një farë stalle për lopët dhe ishte transformuar në burg.

A mund t'ia shpjegosh Gjykatësve nga e kuptove që ishte kthyer në burg. Pe ndonjë diçka që të bëri ty të mendoje se ishte përdorur pastaj si burg?

Py. Po u dinte aty se kishte qenë stallë e kafshëve se kishin pasur vendin ku kanë hëngër kafshët dhe do jashtëqitje të kafshëve edhe nëpër [e pakuptueshme] ndijshin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po jo, nga e kuptove që e kishin përdorur si burg?

Py. Muj me thanë aty *[REDAKTUAR]* e ka ditë që janë në q'atë shtëpi, tash kur shkumë ne në burg. Po tjetërkund s'pamë veç aty, tani fjalë mbas fjale morëm vesh që në stallë i kanë

mbajtur. Kanë treguar edhe ata kur kanë ardhur, po harroj. Në podrum.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin. Në po atë faqe i ka thënë Prokurorisë: "Të gjitha këto ndërtesat aty ngjitur ishin të mbushura me vrima plumbash".

Py. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Domethënë se në anglisht është "vrima predhash" në përgjithësi, e ke fjalën për vrima të mëdha, domethënë predhash të mëdha, apo predhash të vogla, siç janë plumbat?

Py. Të vogla, të vogla.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A kishte ndonjë shenjë a gjurmë nën ndërtesa apo në oborr se mos vallë mund të ishte bërë ndonjë përleshje ushtarake e armatosur për shembull - nuk e di - ndonjë automjet ushtarak i braktisur apo pajisje ushtarake të braktisura apo uniforma të braktisura, diçka a pe aty?

Py. Jo. Kurrgjë nuk pamë të braktisur veç pamë vrima plumbash, se këta ushtria serbe veç gjujshin shtëpia, ndërtesa, ça pajshin, gjithkah, veç i gjujshin. Q'ashtu disa bira nëpër dërrasa, sidomos [e pakuptueshme].

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të kuptova mirë, që thua që vrimat e plumbave do të thotë që i kishin bërë serbët? Do të thotë që kanë serbët aty kanë

gjuajtur?

Py. Kanë gjuajtur ata, nuk u afrojshin te shtëpiat, ato i gjujshin q'ashtu prej largësisë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ke dëgjuar ndonjëherë, ofensiva serbe a arriti deri te ky burgu, te ky vendi ku ishte burgu nga fundi i prillit 1999 apo edhe më vonë? Domethënë a ke marrë vesh, po s'pate marrë vesh nuk ka problem edhe kjo pranohet.

Py. Kemi marrë vesh se kanë ik refugjat, tanë ditën kanë ik prej asaj anës kanë ardh kah na, për me hy në Prishtinë. Se i ndiqte kjo ofensiva mbrapa.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo pyetjen e kisha ndryshe: Ti vetë a ke marrë vesh serbët shkun edhe tek ai vend ku ishte burgu? A kanë kaluar edhe aty?

Py. Po, me siguri kanë kalu. Nuk kanë lënë shtëpi pa kontrollu. Krejt rend i kanë hi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po si e ke marrë vesh ti këtë?

Py. E di se gjithkund nuk ka pasur shtëpi që s'e kanë kallë e s'e kanë kontrolluar, kah ka kapërcy ofensiva serbe. Krejt shtëpiat i kallshin, veç kështu di që atë s'e kanë kallë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por në këtë rast e ke fjalën vetëm për vrimat e plumbave. Domethënë për shkak të vrimave të plumbave mendon se aty kanë kaluar serbët, thjesht se mund të kenë qëlluar mund të kenë

shti me armë.

Py. Po sigurisht se u dukshin vrimat edhe u dukshin dërrasat e shpumë nga ai hambari që kanë mbajt grurin, krejt me bira ishte kanë. Ku ka pas dërrasa, dukeshin birat.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo që dua të kuptoj është se nga mund ta kuptoje ti që serbët i kishin bë ato vrima plumbash dhe jo ndonjë tjetër.

Py. UÇK-ja nuk ka pas nevojë me i ba ato vrima aty.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Dua të bëj tani disa pyetje për zhvarrimin. E kuptoj që është një temë pak e ndërlikuar. Por i kam disa pyetje të veçanta.

Dje u fol, u diskutua për kufomën e *[REDAKTUAR]* edhe na tregove që ti vetë ishe paksa i larguar. A të kujtohet nëse i kishte të veshur këpucë, a kishte këmbët e mbathura?

Py. Jo të zbathura i ka pas.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Dje në transkript faqja 75, rreshtat 6 dhe 10 the se disa prej të tjerëve gjatë zhvarrojjes thanë se kishin parë vrima plumbash. Ti vetë the se nuk i pe se ishe pakëz i larguar.

Py. Unë prej largësisë -- nuk më kanë lanë më u afru afër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e di e di. E mësova këtë gjë, nuk ndiheshe mirë.

A dëgjove dikën që ishte në zhvarrosje të thotë që

*[REDAKTUAR]* kishte krahët, duart dhe këmbët të thyera? A e përmendi dikush këtë?

Py. Po, po dikush e ka fol kështu. Po. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ti vetë a pate mundësi me e këqyr.

Py. Jo nuk më kanë leju me u afru afër hiç.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Në deklaratën që i ke dhënë Prokurorisë ke thënë se kur u zhvarros *[REDAKTUAR]* i ndjerë, kishte qëndruar aty dy muaj tashmë.

Py. Më shumë ka qenë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është në dokumentin 076509-TR-ET RED1. Nga e kuptove që *[REDAKTUAR]* kishte dy muaj i vdekur?

Py. Prej që atë ditë që i kanë liruar të tjerë të burgosur, e kanë ndalë vetëm ata të dy. Atë ditë a kanë kry ata misionin. Se qëllimisht i kanë ndalë, nuk i kanë lëshuar këta të dy. Këta të tjerët kanë ardhur për Prishtinë, ata të dy i kanë ekzekutuar. Kush, qysh, nuk e di. Se aty kanë ikur dhe ushtarët, s'ka ndejt kurrkush më atje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky është një përfundim apo ta ka thënë dikush, të ka tregu dikush për këtë?

Py. Jo s'ma ka thënë kurrkush po kjo dihet se i kanë liruar të gjithë. Ata të dy i kanë ndalë edhe ata vetë kanë ikur.

Domethënë i ka ekzekutuar dikur edhe kanë ikur për Prishtinë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur thua "ata që kanë ikur për Prishtinë". Kush janë?

Py. Ushtarët komplet, s'ka ndejtur kurrkush ma atje hiç. Kush ka qenë aty s'e di, jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur thua ushtarët, për cilët ushtarë e ke fjalën?

Py. Të UÇK-së.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Këtu në transkript tani shikoj që the "dy muaj". Po the "edhe më shumë".

Py. Po. Pak ma shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E përmenda për procesverbalin se nuk i thashë me saktësi fjalët që the.

Dje në faqen 28, rreshtin 12, the se *[REDAKTUAR]* nuk donte me të kallxu se prej kujt e kishte marrë informacionin se ishte i varrosur *[REDAKTUAR]*. Në deklaratën që i ke dhënë Prokurorisë dhe përsëri do ta jap numrin -- them këto numrat për procesverbalin -- bëhet fjalë për dokumentin me numër 076509_TR-ET RED1 Pjesa 2, rreshtat 11 dhe 12 - ke thënë dhe po flisje për *[REDAKTUAR]* këtu, se informacioni që e kishte marrë se ku ndodhej i varrosur *[REDAKTUAR]* nuk tregoi e ti nuk mund ta pyesje *[REDAKTUAR]* Nuk e pyesje dot *[REDAKTUAR]* në atë

moment.

Pyetja që kam: Pse nuk e kishte të mundshme ti me e pyet *[REDAKTUAR]* ti në atë kohë për këtë gjë?

Py. Jo unë e kam pyetur *[REDAKTUAR]* po s'ka dashtë me më tregu. Ai më ka thënë dikush shko q'aty rreth burgut, mos po e gjejmë diku. I kishte pas thënë dikush *[REDAKTUAR]* se "djalin nuk e ke po shko lype dikund".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kuptoj këtë që thoni. Por dje na the që e pyete dhe nuk deshi me të tregu. Por kur ke folur me Prokurorinë i ke thënë Prokurorisë që nuk e pyesje dot. Por faktikisht nuk është se ke dashur të thuash këtë, apo jo?

Py. Unë e kam pyetur po s'ka dasht me më tregu kush. Se deri në atë ditë na e kemi lyp *[REDAKTUAR]* të gjatë. Kena menduar që është i gjallë. Atë ditë e kemi marrë vesh që dikund është i vdekur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin.

Dje - dhe është në transkript faqja 22, rreshti 16 dhe faqja 22, rreshti 17 dhe në faqen 57 rreshtat 6-10 - na the se ti dhe të tjerët kur ishit në shtëpinë e *[REDAKTUAR]* mësove emrin e njërit prej personave që e kishin mbajtur të ndaluar së bashku me *[REDAKTUAR]* dhe ishte *[REDAKTUAR]*.

Dhe pyetja që kam është kjo: A di gjë pse e kishin ndaluar edhe *[REDAKTUAR]*?

Py. Me *[REDAKTUAR]* kam ndjet unë -- nja dy ditë ka ndejt tek na dhe ka ec. Ai më ka treguar gjatë luftës i kishte pas ble një kallash edhe ka dalë dikun në mal e ka provu kallashin. Tani e kanë marrë UÇK-ja në burg "pse ti qite me kallash". Kurrgjë tjetër s'kishte bërë njeri, veç që ka e provuar kallashin që e ka ble me pare. Edhe e kanë burgosur në Zllash. Ka ndej - s'e di sa ka ndejt, e kam harru.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po a të tha ndonjë gjë që kishte qëlluar ndonjërin apo të UÇK-së?

Py. Jo, veç e ka provu a po punon kallashi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe tha që pastaj e arrestuan.

Py. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk ta tha ty, po tha.

Py. Q'ashtu tha, do jua tregoj të tanëve për këtë më kanë burgosur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra të tha edhe ty. Ishe edhe ti.

Py. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dje na thatë se i ndjeri *[REDAKTUAR]*, u shpall *[REDAKTUAR]* dhe për këtë e arrestuan. Është transkrupti faqja 16, rreshti 13 dhe 14. Në dëshminë që i ke dhënë Prokurorisë, 076509-TR-AT RED1, Pjesa 2, faqja 25 ju thatë, -- ju bënë pyetjen:

"A e tha ndonjërit ose të ndaluarit pse e kishin mbajtur të ndaluar dhe *[REDAKTUAR]*?"

Dhe përgjigja jote ishte:

"Nuk kam nevojë të më thonë ata asgjë lidhur me këtë sepse po ju them se *[REDAKTUAR]* e kanë mbajtur të ndaluar se para luftës ai rrihej, rrihte njerëz. Dhe disa nga ata burra, persona që ka rrahur më përpara ishin pastaj në pozicione të larta atje. Dhe e arrestuan dhe e shpallën *[REDAKTUAR]*".

Kur fole për "burra, persona që kishte rrahur" dhe ishin në "pozicione të larta" atje lart, çfarë pozicionesh, çfarë pozitash të larta ke dashur të thuash?

Py. Aty jemi keqkuptuar se për pozicione nuk i di unë. Veç unë e kam kujtu që gjithë herët dikush prej q'atyne që e ka rrah *[REDAKTUAR]*, qëlloi atje. Çfarë pozicionesh nuk jua di, çfarë pozicione kanë pasur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A doje të thoje për politikë a UÇK-së, e kishe fjalën në politikë a në UÇK. Ku ishin?

Py. Jo në UÇK, në UÇK. Dikush ka qenë ja ka pas *[REDAKTUAR]* inatin dhe e kanë marrë nalt.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ke ndonjë emër, di ndonjë emër që kishte rrahur ai? Me atë që di ti.

Py. Jo vallahi se ka pas shumë e nuk i di unë ato. Shumë probleme ka pas.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ta perifrazoj, ta përsëris, të lutem më korrigjo në qoftë se nuk po e them mirë unë. Ju thoni se ti mendon se mbase ai ka rrahur ndonjë që ka qenë te UÇK-ja dhe ishte kështu si për hakmarrje.

Py. Besoj se q'ashtu. Unë besoj që ashtu diçka është.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka ndonjë arsye më konkrete, më specifike pse mendon ti se është kjo arsyeja? A e di gjë ti për personat me të cilët ishte zënë ishte futur në sherr që ishin nga UÇK-ja.

Py. Nuk di, nuk di. Shumë njerëz ka pas që është fut në sherr, është rrah. Ka pas probleme me shumë njerëz, nuk muj me ditë. Veç mendja ma ka marrë që dikush prej atyre e kanë marrë edhe kanë likujduar *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e dini arsyen pse futej nëpër sherre, pse futje në këto lloj sherresh?

Py. Po shoqëria, i ka pas do q'ashtu do shoqëri të këqij, do probleme. Do tani ky *[REDAKTUAR]* a qenë i fuqishëm me gjithë me gjithkënd u rrihte. Ata tjetër kush e bënte sherrin, *[REDAKTUAR]* e hante çdo herë [e padëgjueshme].

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Arsyet i di ti? A kishte ndonjë mosmarrëveshje për para, a për bindje politike.

Py. Jo për politike, po probleme të vetat. Tash një shok i

tij me bo një problem, *[REDAKTUAR]* e merrte përsipër menjëherë atë problem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. A keni frikë nga ndonjë pse po jep këtë dëshmi?

Py. Nuk kam frikë se nuk jap të pavërtetë, kurrgjë. Të vërtetës kurrë s'i frigohem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Deri tani a të kanë kërcënuar ndonjëherë, lidhur me bashkëpunimin me Prokurorin me ZPS-në a me Dhomat e Specializuara?

Py. Nganjëherë, një herë e kam dyshuar diçka, po jo nuk kam fakte. Nuk jam i sigurt.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pse dyshove cili ishte ai dyshim? A do të na tregosh më shumë?

Py. Një njeri i panjofshëm mu lajmërojke, dojte me pas kontakt me mu si qysh edhe kohët e fundit u largu ai njeri edhe nuk besoj. A pata dyshu në të.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E njihje ti?

Py. Jo s'e kam njohur përpara kurrë. Vetë mu lajmërua ai njeri, tani po e dyshoj, se edhe atij njeriu i kam ndejt në distancë gjithëherës. Nuk po besoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të tha gjë pse donte të të takonte.

Py. Donte pa lidhje, kështu. Kishte qejf me pas kontakte me mu. Unë s'dojsha me të, q'ashtu tash. Dikur e largova.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra ju la të qetë pastaj dhe nuk të mori më, nuk të lajmërii më.

Py. Jo, jo hiç kohën e fundit, hiç.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Ne të kemi bërë shumë pyetje. A ka ndonjë gjë që do t'i thuash Trupit Gjykues se çfarë ka ndodhur, çfarë të ka ndodhur, *[REDAKTUAR]*?

Py. Për gjatë luftës është fjala? Qysh?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në përgjithësi. Ne të kemi bërë shumë pyetje.

Py. Jo hiç.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase ka ndonjë gjë që do ta thuash se mbase ne nuk e kemi përmendur dhe ti mendon që është e rëndësishme dhe do ta ndash me ne. Një gjë që mbase ne nuk ta kemi pyetur?

Py. Nuk po më kujtohet kurrgjë. S'po di.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. Mirë. Tani po shoh, pyes një herë kolegët mbase ka ndonjë pyetje që ka mbetur që duam t'jua drejtojmë.

Py. [E padëgjueshme].

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Zoti dëshmitar, një pyetje shumë e shkurtër.

Sot, faqja 13 e transkripit rreshtat 14 dhe 15, ju përmendët dikë që quhej *[REDAKTUAR]*. A mund të na thuash a

ishte *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në atë kohë ishte më i ri se ti?

Py. Po më i ri.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Mirë faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Zonja Sekretare e Gjykatës, a mund të na ktheni sërish në seancë publike?

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

[Seancë e hapur]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit zonja Sekretare e Gjykatës.

Zoti dëshmitar erdhëm në fund të dëshmisë. E kuptoj që ka qenë goxha angazhuese. Do të doja t'ju falënderoja për përpjekjet tuaja për të na dhënë këtë dëshmi dhe besoj se do të na ndihmojë edhe ne që të gjejmë të vërtetën.

Py. Faleminderit shumë edhe juve faleminderit edhe kam besim të plotë në drejtësinë e juaj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit zoti dëshmitar. Ju urojmë rrugë të mbarë dhe ju kujton se nuk duhet të diskutoni asgjë nga gjërat që keni folur këtu në sallën e gjyqit me asnjë person.

Py. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

do ju ndihmojnë, do t'ju ndihmojë asistentja e Gjykatës të dilni nga salla e gjyqit.

Py. Ditën e mirë.

[Dëshmitari largohet]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] në rregull. Zonja Prokurore a ka ndonjë gjë që doni të parashtroni në këtë moment?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po e nderuar. Faleminderit. Thjesht një aspekt procedural i shkurtër. Dje Trupi Gjykues i kërkoi ZPS të informonte Trupin Gjykues dhe palët për javën e planifikuar, kur planifikon java të jetë ZPS-ja në gjendje të përfundojë me paraqitjen e provave në përputhje me rregullën 129 të Rregullores.

Të nderuar, siç e dini më 23 nëntor ne dorëzuam njoftimin lidhur me 3 dëshmitarët e fundit që pritet të dëshmojnë nga ana e Prokurorisë që është parashtrimi i protokolluar 0068 dhe prandaj kemi dëshmitarin W04485 që është parashikuar për javën e 17 janarit. Dëshmitarin 4484, planifikuar për javën e katërt të janarit dhe pastaj dëshmitarin e fundit 4849, planifikuar për javën e 31 janarit deri më 4 shkurt që do të jetë edhe dëshmitari i fundit pas të cilëve ZPS-ja nuk pret që të ketë dëshmitarë shtesë.

Po ashtu nuk presim të kemi materiale provuese për t'u zbuluar pas dëshmitarit të fundit. Prandaj duhet të jemi në gjendje të dorëzojmë njoftimin zyrtar në përputhje me

rregullën 129 ose po atë ditë që është e premte, më 4 shkurt ose maksimumi të hënën, pas të premtes.

Pra kjo është përgjigja jonë sa i takon pyetjes tuaj lidhur me planifikimin. Pra deri më 7 shkurt. Se e premtja është 4 shkurt, kështu që i bie 7 shkurt.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sigurisht është edhe kërkesa për t'u zbuluar provat që janë përdorur me dëshmitarin e fundit sepse i bie që kemi hyrë në muajin shkurt dhe duhet të dalë vendimi lidhur me 4712. Por, na sqaro më shumë, të paktën të dimë se çfarë do të ndodhë në muajin shkurt. Faleminderit.

A ka ndonjë gjë tjetër për të ngritur nga ana juaj zonja Prokurore.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo në këto momente. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka ndonjë gjë që doni të ngrini nga ana juaj në këto momente, nga ana e Mbrojtjes?

Avokat a ka ndonjë gjë që doni të ngrini?

Z. VON BONE: [Përkthim] Vumë re se u -- dua të them se dorëzuam dokumentin e rishikuar, domethënë do ta dorëzojmë ose sot ose nesër, dokumentin e rishikuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase për të korrigjuar gabimet ortografike.

Faleminderit avokat.

Nëse palët dhe Mbrojtja e Viktimave nuk kanë asgjë për të shtuar për Trupin Gjykues do të rimblidhemi të martën, më 18 janar në orën 09.30 me dëshminë e dëshmitarit W4485. Tani po i afrohemi pushimeve të dimrit.

Falënderoj palët, Mbrojtjen e Viktimave, përkthyesit, teknikët, sigurinë për pjesëmarrjen dhe ndihmën e tyre.

Seanca mbyllet.

--- Seanca mbyllet në orën 10.16